



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Bregu i Diellit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr.Prot.: _____

Datë: ____/____/____

UDHËZIM PËR STUDENTËT E FIM-it PËR TEMË TË DIPLOMËS BACHELOR DHE PRAKTIKËN PROFESIONALE

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të cilët kanë përfunduar të gjitha provimet dhe përgatiten për realizimin e temës së diplomës Bachelor duhet vepruar sipas këtyre procedurave:

- Për hartimin e punimit të Diplomës Bachelor studenti duhet të propozojë/përzgjedhë Mentorin për temë të diplomës në programin në të cilin i ka ndjekur studimet,

- Studenti duhet të ketë të përfunduara të gjitha provimet e parapara në Programin Studimor të regjistruar,

- Pas përzgjedhjes së mentorit për temë të diplomës, përcaktohet titulli i temës së Diplomës, Lënda mësimore nga e cila punohet punimi i diplomës, dhe përmbajtja e shkurtër e punimit,

- Në ndërkohë studenti duhet realizuar Praktikën Profesionale në kohëzgjatje prej 1 muaj. Praktika Profesionale duhet realizuar në ndonjë Kompani ose Organizatë Punuese vendore dhe po ashtu ndërkombëtare. Praktika profesionale duhet të jetë e fushës së programit të studimit dhe e lëmisë së njëjtë me atë të Punimit të Diplomës.

- Kërkesa për Praktikë Profesionale bëhet tek Prodekani për mësim, ku merret formulari përkatës. Studenti mund të kërkojë fillimin e praktikës profesionale edhe me minus një provim nga totali i provimeve të dhëna.

- Për përfundim të suksesshëm të Praktikës Profesionale, student duhet dorëzuar Formularin e nënshkruar dhe vulosur nga kompania ku ka kryer Praktikën. Formulari së bashku me fletëparaqitjen nga mentori i kandidatit duhet dorëzuar të Administrata e studentëve.

- Studenti duhet realizuar Ditarin e Praktikës, ku paraqet njohuritë e fituara gjatë praktikës profesionale për çdo ditë gjatë periudhës 1 mujore. Ditari i praktikës i shtypur në letër i dorëzohet Mentorit të temës për aprovim.

- Praktika profesionale duhet përfunduar para fillimit të përgatitjes së Temës së Diplomës.

- Praktika Profesionale vlerësohet nga ana e Mentorit në sistemin SEMS me vlerësim kaloi.

- Pas evidentimit nga Administrata e FIM-it për përfundim të të gjitha provimeve, plotësohen dy formularë:

- Nga ana e Mentorit plotësohet formulari - LETËR PËRCJELLËSE PËR HAPJE TË PROCEDURËS PËR TEMËN E DIPLOMËS BACHELOR i cili shkarkohet nga linku i FIM-it, ku propozohet Titulli i temës, Lënda mësimore nga e cila punohet tema, propozohen tre anëtarët e Komisionit (Kryetari, Mentor i temës-anëtar, dhe Anëtar i tretë).

- Nga ana e Mentorit plotësohet formulari - KËRKESË PËR LEJIMIN E TEMËS SË DIPLOMËS BACHELOR. Formularin studenti e tërheqë tek Referenti/ja për Çështje studentore. Formulari plotësohet së bashku me Mentorin e temës. Në këtë formular paraqitet emri i Punimit të Diplomës dhe kapitujt kryesor. Formularëve ju bashkëngjitet edhe transkripti i notave. Më tutje kërkesa përcillet tek Shefi i Departamentit për aprovim, dhe të Prodekani për mësim. Në raste të veçanta kërkesa mund të dërgohet në Komisionin për studime të FIM.

- Punimi i diplomës duhet të realizohet në afat prej 2 javë deri në 3 muaj. Me kalimin e afatit prej 3 muaj pa realizim të punimit, studenti së bashku me Mentorin e temës duhet kërkuar vazhdim edhe për 2 muaj. Kjo kërkesë duhet të ketë arsyeshmërinë, dhe dërgohet për aprovim të Komisioni për studime. Nëse as pas 2 muaj nuk përfundohet punimi i Diplomës, kandidatit i tërhiqet procesi i temës së diplomës, dhe rifillon procedurën duke zgjedhur tjetër temë dhe tjetër Mentor.

- Punimi i diplomës duhet ti plotësojë kriteret akademike dhe teknike të punimeve të diplomës të përcaktuar me Rregullore të UP, ku përfshihen pjesët strukturore të temës: Titulli, Stema e Universitetit, Përmbajtja, Lista e Figurave, Lista e Tabelave, Lista e Simboleve të Përdoruara, Lista e Shkurtesave të Përdoruara, Hyrja, Kapitujt, Përfundimi, Literatura (Referencat në literaturë), Deklarata etike, si dhe kërkesat teknike - Format i fletës (A4); Margjinat 2.5 në të gjitha anët, format i tekstit barazuar në dy anët-Justified; madhësia e tekstit në punim - Times New Roman (12); Teksti, tabelat, figurat, simbolet në figura dhe në tabela, etj - Times New Roman (12), Fusnotat në fund të faqes, përshkrimi i variablave të përdorura në ekuacione - Times New Roman (11); Titulli i kapitullit – Arial (16), Titulli i seksionit - Times New Roman (14), Titulli i nënseksionit - Times New Roman (12),

- Studenti me përpikëri duhet ta aplikon Formatin e hartimit të Punimit të Diplomes (Template). Studenti punon në këtë format duke i vendosur shënimet përkatëse që kërkohen për punim diplome.

- Pasi kandidati ta ketë përfunduar punimin e diplomës dhe është aprovuar nga Mentori, punimi në mënyrë elektronike (e-mail) nga Mentori dërgohet të dy anëtarët e tjerë të komisionit për vlerësim. Nëse anëtarët e komisionit kanë vërejtje e njoftojnë Mentorin i cili kërkon nga kandidati ti bëjë përmirësimet e duhura sipas sugjerime dhe vazhdon me procedurë.

- Nëse kandidati ka përfunduar realizimin e temës dhe ka marrë aprovimin nga mentori dhe anëtarët e Komisionit, atë e printon në letër A4 në njërën anë, në lidhje të fortë në 5 kopje, dhe dërgohet në Arkivë të Fakultetit për protokollim, si dhe për Diskutim Publik. Punimi qëndron 1 javë në zyrën e Arkivës dhe për Diskutim Publik. Tri kopje të punimit të Diplomës me lidhje të fort i dërgohen secilit anëtar të komisionit.

- Kandidati kur e dorëzon punimin e diplomës në arkiv obigohej ta paraqet në SEMS Punimin e diplomës dhe Praktikën Profesionale për vlerësim nga ana e Mentorit të temës, përkatësisht Komisionit për diplomim.

- Pas kalimit të afatit minimal prej 1 javë, nëse nuk ka pas vërejtje në punim nga ndonjë palë, caktohet data e mbrojtjes publike të punimit. Punimi i diplomës duhet mbrojtur (prezentuar) nga Kandidati para Komisionit të caktuar, dhe është mbrojtje publike. Mbrojtja e punimit të diplomës bëhet në hapësirat e FIM-it.

- Mentori kujdeset për marrjen dosjes së studentit nga sekretarja e Fakultetit dhe Librin e Procesverbalit të Punimit të Diplomave.

- Pas përfundimit të prezentimit të temës së Diplomës, Komisioni jep vlerësimin e temës me notë, dhe nëse nota është pozitive shpallë marrjen e titullit të kandidatit *Bachelor i Inxhinierisë Mekanike, Programi...*

- Punimi i diplomës notohet nga ana e Komisionit në sistemin SEMS dhe Komisioni shtyp Vendimin e diplomimit që i dërgohet Administratës.

- Punimi i diplomës vlerësohet me notë nga 6 (gjashtë) deri me 10 (dhjetë).

- Punimi i diplomës dhe Praktika profesionale marrin 10 ECTS kredi.

- Pas Diplomimit, studenti duhet të aplikojë për lëshimin e Diplomës tek Referenti/ja për çështje studentore, dhe së bashku me të në Administratën Qendrore të UP.

- Ky Udhëzim bazohet në Rregulloren e FIM për studimet Bachelor.